



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 67/1 Prot.

Tiranë, më 10.02 2023

Lënda: Mendim mbi Manualin e Inspektimit për Pronësinë Intelektuale.

**INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT**

Adresa: Rruga "Shygyri Bërxolli", Nr. 65

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 424 prot., datë 02.02.2023, me anë të së cilës dërgoni për mendim Manualin e Inspektimit për Pronësinë Intelektuale, në zbatim të shkronjës "d", të nenit 16, të ligjit nr. 10433/2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në vijim gjeni vlerësimin e Inspektoratit Qendror.

Vlen të theksojmë se nga përmbajtja e manualit në tërësi, konstatojmë se implementohen parimet dhe rregullat e ligjit për inspektimin, si dhe akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij. Ndërkohë, me qëllimin unifikimin e procedurave inspektuese, si dhe përcaktimin më të qartë të procesit inspektues, do t'u sugjeronim si vijon.

Në Kapitullin II "Veprimtaria e inspektorit/grupit të inspektimit", të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1 "Roli i inspektorit/grupit të inspektimit", në nënpikën 1.3, fjalët "ligjin e inspektimit" të zëvendësohen me togfjalëshin "legjislacionin për inspektimin".

Në pikën 3, "Mënyra e plotësimit të dokumentacionit (procesverbal, listë-verifikimi)", në nënpikën 3.1, sqarimi lidhur me listë-verifikimin", të riformulohet si më poshtë:

*"Sqarim: "Listë-verifikimi është një dokument që përcakton përputhshmërinë me ligjin specifik për fushën e inspektimit, që mbulon inspektorati shtetëror përkatës. Listë-verifikimi plotësohet në të gjitha rubrikat përkatëse, përpara procesverbalit dhe është pjesë integrale e tij."*

Po në pikën 3, në nënpikën 3.2.1, fjala "hapet" të zëvendësohet me fjalën "plotësohet", fjala "me hyrjen" të hiqet dhe në fund të fjalisë, të shtohet togfjalëshi "të përcaktuar në Autorizim".

Në Kapitullin III "Unifikimi i procedurave të inspektimit për monitorimin e të drejtave të pronësisë industriale", në pikën 18 "Dokumentimi i gjithë veprimeve të kryera gjatë hetimit administrativ", në nënpikën 18.2, shkronja c, fjalia e dytë të riformulohet si më poshtë:

*"Pas plotësimit të listë-verifikimit, inspektori/grupi i inspektimit fillon plotësimin e procesverbalit të inspektimit".*

Gjithashtu, tek pjesa "1.2 Inspektimi ex-officio/kryesisht", në pikën 15 "Procesi i shkatërrimit të mallrave", në nënpikën 15.3, të rishikohet fjalia e parë, ku thuhet "...brenda afatit në pikën 9 të këtij neni...", me qëllim qartësimin e saj.

Me sugjerimet e mësipërme, "Manuali i inspektimit të pronësisë intelektuale, "Për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut" vlerësohet në përputhje të plotë me legjislacionin për inspektimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**

